



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Realizimin e Reformës Zgjedhore

Nr 3055 prot

Tiranë, më 13.7.2026

Lënda: Kërkesë për zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm.

Z. NIKO PELESHI

KRYETAR I KUVENDIT

KONFERENCËS SË KRYETARËVE

I nderuar zoti Kryetar,
Të nderuar deputetë,

Kuvendi, me qëllim realizimin e një reforme zgjedhore të plotë dhe gjithëpërfshirëse, në datën 27.10.2025, me vendimin nr. 74/2025, miratoi ngritjen e Komisionit të Posaçëm për Realizimin e Reformës Zgjedhore me një numër të barabartë anëtarësh të tij të shumicës dhe të pakicës parlamentare dhe që bashkëdrejtohet nga dy kryetarë, një nga Partia Socialiste dhe një nga Partia Demokratike.

Komisioni i Posaçëm Parlamentar ka për detyrë: a) hartimin e ndryshimeve legjislativë për reformën zgjedhore; b) trajtimin e rekomandimeve në raportet e OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet vendore të 14 majit 2023, për zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025; si dhe të zgjedhjeve të mëparshme të patrajuara; c) trajtimin e rekomandimeve të institucioneve përgjegjëse për zgjedhjet, të partive politike parlamentare dhe organizatave jofitimprurëse; ç) hartimin e një ligji për financimin e partive politike.

Pranë Komisionit është ngritur Grupi i Ekspertëve Teknikë.

Gjithashtu, në vendimin nr. 74/2025 Kuvendi ka parashikuar bashkëpunimin dhe mbështetjen e veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm nga ekspertë të OSBE/ODIHR-it, Këshillit të Europës, ekspertë të Komisionit të Venecias, si dhe përfaqësues dhe/ose ekspertë të BE-së dhe SHBA-ve që të ndjekin, të japin asistencë dhe ekspertizë teknike në punimet e Komisionit.

Gjatë veprimtarisë së deritanishme të Komisionit është hartuar dhe diskutuar projektligji “Për financimin e partive politike”. Ky projektligj aktualisht është në fazën përfundimtare të shqyrtimit të tij nga Grupi i Ekspertëve Teknikë dhe në vijim do të kalojë për miratimin përfundimtar në Komision. Procesi i hartimit të tij ka qënë gjithspërfshirës dhe transparent duke organizuar me aktorët politikë, OJF-të, partitë politike dhe organizatat ndërkombëtare dy tryeza të rrumbëllakta si dhe ka dhënë mendim për tekstin e tij ODIHR dhe Komisioni i Venecias. Mendimi më i fundit është ai i Komisionit të Venecias i cili është miratuar në mbledhjen plenare të këtij Komisioni në datën 12 qershor 2026 dhe i është përcjellë disa ditë më vonë zyrtarisht Kuvendit dhe Komisionit të Posaçëm.

Për këtë projektvendim kanë paraqitur opinionet e tyre me shkrim edhe 12 organizata jofitimprurëse, organe shtetërore dhe disa organizma ndërkombëtarë që veprojnë në Shqipëri si NDI, UN Women, Westminster Foundation for Democracy.

Procesi aktualisht është në fazat e fundit të draftimit dhe ka pasur vonesë për shkak të ardhjes vetëm së fundmi të mendimit të Komisionit të Venecias dhe numrit të lartë të opinionëve dhe mendimeve që duhet të trajtohen. Përfundimi i punës për hartimin e këtij projektligji kërkon edhe pak kohë për të lënë në dispozicion të ekspertizës teknike, të partive politike dhe aktorëve të tjerë për përgatitjen e draftit përfundimtar të tij.

Krahas punës për hartimin e projektligjit “Për financimin e partive politike”, Komisioni po punon për hartimin e ndryshimeve legislative për reformën zgjedhore, si dhe trajtimin e rekomandimeve në raportet e OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet vendore të 14 majit 2023, për zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025; si dhe të zgjedhjeve të mëparshme të patrajuara.

Janë organizuar seanca degjimore me përfaqësues të institucioneve të drejtësisë në lidhje me përmirësimin e bazës ligjore për parandalimin dhe luftimin e veprave penale në fushën e zgjedhjeve dhe njëkohësisht forcimin e bashkëpunimit institucional në këtë drejtim.

Së fundmi, Bashkimi Europian ka vendosur të caktojë një ekspert ndërkombëtar pranë Komisionit të Posaçëm i cili fillimisht do të asistojë Komisionin me paraqitjen e standarteve ndërkombëtar dhe modeleve më të mira legislative të vendeve të ndryshme në lidhje me dy aspekte të cilat janë plotësisht të parregulluara në Kodin Zgjedhor: financimin e palëve të treta në fushatën/periudhën zgjedhore dhe media on line gjatë fushatës zgjedhore. Për këtë dy aspekte të rëndësishme eksperti ndërkombëtar do të paraqesë propozimin më shkrim për anëtarët e Komisionit në fund të muajit korrik 2026. Në vijim për këtë dy çështje Komisioni ka planifikuar të zhvillojë edhe dy tryeza të rrumbullakëta për to.

Gjithashtu në bashkëpunim me NDI Prezenca në Shqipëri dhe ODIHR Komisioni i Posaçëm do të organizojë në datën 28 korrik 2026 një tryezë të gjerë diskutimi për një nga çështjet më thelbësore dhe më të diskutueshme në Shqipëri, atë të keqpërdorimit të burimeve shtetërore në zgjedhje. Në datën 29 Korrik 2026 është parashikuar të zhvillohet një takim i ngushtë mes Grupit të Ekspertëve Teknikë dhe ekspertëve të ODIHR për të diskutuar dhe gjetur zgjidhje për çështje konkrete dhe parashikimet e reja normative në këtë fushë.

Për këtë arsye, me qëllim realizmin e këtyre aktiviteteve që parashikohen të zhvillohen në fund të muajit korrik 2026 e në vijim dhe njëkohësisht për t'i dhënë mundësi shtesë palëve politike në Komision për diskutuar dhe dakortësuar për zgjedhje politike që janë të nevojshme të paraprijnë procesin e hartimit teknik të dispozitave të Kodit Zgjedhor paraqitet projekvendimi për shtyrjen e afatit të funksionimit të këtij Komisioni.

Bashkëkryetarët

Damian GJIKNURI

Oerd BYLYKBASHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT - VENDIM

Nr. ____ /2026

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 74/2025 TË KUVENDIT “PËR NGRITJEN E
KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR PËR REALIZIMIN E REFORMËS
ZGJEDHORE”**

Në mbështetje të neneve 77, pika 1, dhe 78 të Kushtetutës, neneve 24, 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Bashkëkryetarëve të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Realizimin e Reformës Zgjedhore,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

- I. Në pikën IX, fjalia e parë ndryshohet si vijon: “IX. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij deri në datën 30 nëntor 2026.”
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Niko PELESHI